

VENDIM
Nr. 1026, datë 16.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 703, DATË 9.9.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
TË PRONËS SHTETËRORE ME NOMENKLATURË K-34-112-127-D, ME NUMËR
PASURIE 402, 403, 404, 405, 406, 410 (NUMËR 19, SIPAS HARTËS SË KADASTRËS
DAMT), 411 (NUMËR 20, SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 412, 413 E 414,
ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE
LIBOFSHË, DHE TË PRONËS SHTETËRORE SIPAS HARTËS TREGUESE, ME
NOMENKLATURË K-34-111-(111-D), ME NUMËR PASURIE 220/1, 220/3, 221/1,
221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 E
232/1, ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA
ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 703, datë 9.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

a) Në titull dhe pikën 1 hiqen pronat me numër pasurie “227/1” dhe “229/1” dhe shtohet prona me numër pasurie “218/6”.

b) Aneksi II, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI II
ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE
REMAS

Nr. rendor, Njësia administrative, Zona kadastrale, Numri i parcelës, Sipërfaqe në m²

1. Remas 2085 218/6 13125

2. 220/1 33774

3. 220/3 64593

4. 221/1 18548

5. 221/3 148757

6. 224/1 166155

7. 225/1 149506

8. 226/1 144257

9. 227/3 64766

11. 228/1 16256

12. 228/3 90262

13. 229/3 98642

15. 230/1 81900

16. 231/1 72360
17. 232/1 34410